



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIONI PËR MBROJTJEN
E MJEDISIT TË KOSOVËS

KOSOVSKA AGENCIJA
ZA ZAŠTITU SREDINE

KOSOVO ENVIRONMENTAL
PROTECTION AGENCY

Instituti për Planifikim Hapësinor – Institute for Spatial Planning – Institut za Prostorno Planiranje

DATE/A:	20.04.2012
REFERENC-Ë:	/AMMK/2011
PËR/ZA/TO:	Dr.sc Ilir Morina, Kryeshef Ekzekutiv
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Luan Nushi, drejtor në IPH
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport nga pjesëmarrja në panairin ndërkombëtar

I nderuari z. Kryeshef

Të bashkëngjitur e keni raportin e detajuar nga pjesëmarrja ime në panairin ndërkombëtar të mbajtur në Paris lidhur me promovimin e vlerave turistike natyrore. Në raport janë prezantuar opinione të regjistruara nga kontaktet e rastit me pjesëmarrës në panair dhe nga përshtypjet e përgjithshme që janë rezultat i të gjitha segmenteve që janë pjesë e kësaj ngjarjeje me rëndësi për institucionin tonë.

Me respekt,






**Panairi ndërkombëtar
për promovimin e turizmit natyror**

29.03. – 02.04.2012

Paris, Francë



Instituti për Planifikim Hapësinor

Raport nga pjesëmarrja në panairin ndërkombëtar

Vendi: Porte de Versailles
Paris, Francë

Data: 29 Mars deri më 02 Prill 2012

Organizatori: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor përkatësisht Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë dhe Z. Yves Fouque, konsultat i CRET-it dhe koordinatori i projektit .


Pjesëmarrësit: Agjenci dhe organizata nga e gjithë bota.

Pjesëmarrës nga Kosova:

- o Kabineti i Ministrit
- o AMMK (Drejtoria e Parqeve Kombëtare; Instituti për Planifikim Hapësinor)
- o Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm në MMPH
- o MTI (Departamenti i Turizmit)
- o RTK

Donatorë: Tre pjesëmarrës janë ndihmuar nga projekti CRET, ndërsa shpenzimet e të tjerëve janë mbuluar, pjesa më e madhe nga MMPH/AMMK, Vipa Chips, Stone Castle etj.

Të dhëna të përgjithshme për Francën



Flamuri – origjina e tij daton që nga viti 1790 dhe Revolucioni i Francës kur ngjyra e bardhë tradicionale e Francës kombinohen me ngjyrën e kaltër dhe të kuqe, simbole të ushtrisë Parisiene.



Sipërfaqja - 547,030 km², (pa koloni)

Banorët: 62.1 milion, me 2.5 milion shtesë të atyre që jetojnë jashtë territorit të Francës (Guiana Franceze; Guadeloupe; Martinique; Mayotte; Reunion)

Kryeqyteti - Parisi

2.5 mil. banorë qyteti pa rrethinë

12.0 mil. banorë me rrethinë

Rregullimi shtetëror: Republikë unitare gjysmë presidenciale

Kryetari i shtetit: Nicolas Sarkozy, UMP (Qendër e djathtë)

Struktura politike: Franca udhëhiqet në bazë të kushtetutës së vitit 1958 (Kushtetuta e pestë pas revolucionit francez). Kushtetuta e lejon një ekzekutiv të fuqishëm të udhëhequr nga presidenti i shtetit.

Religjioni: Franca është shtet sekular. Më 1905 me ligj është

bërë ndarja e shtetit nga Kisha dhe ndërprerja financiare çfarëdo religjioni në Francë. Në bazë të të dhënave 85% e popullatës janë katolik; 10% myslimanë; 2% protestant; 1% jevrejë dhe të tjerë.

Fakte tjera:

- o GDP per capita në 2008: 30,413€
- o GDP rritja: 0.7% (2008 est.)
- o Shkalla e papunësisë: 9.4% (Qershor 2009)
- o Shkalla e inflacionit: 1% (2008 est.)
- o Mesatarja vjetore e të ardhurave (2007): 21,480€

- o 15.3% janë kursimet mesatare për familje nga të hyrat në dispozicion
- o Prodhimi i energjisë nga era (6%)

Franca është vend i madh evropian që rrethohet nga Deti Mesdhe dhe Oqeani Atlantik.

Pika më e lartë: Maja Mont Blanc (Alpet franceze) me 4807m që paraqet edhe pikën më të lartë në Evropë. Franca është e njohur për: prodhimin e djathit (më shumë se 300 lloje); për prodhimin e verës; prodhimin e parfumeve (Chanel, Dior, Givenchy); dhe prodhimin e makinave (Renault, Citroen, Peugeot); Franca është gjithashtu e njohur për organizimin e garës më të njohur në qiklizëm – Tour de France

PANAIRI

Në Paris përkatësisht në Porte de Versailles (objekt i dedikuar për ngjarje të tilla) për tre ditë me radhë u mbajt panairi për promovimin e turizmit natyror. Ky është njëri ndër panairët e rralla për të mos thënë i vetmi që merret me fushën e turizmit dhe promovimin e vlerave dhe vendeve turistike natyrore.



► Foto nga hapja solemne e panairit

Pjesëmarrja: Pjesë e kësaj ngjarjeje shumë të rëndësishme ishte edhe Kosova përkatësisht natyra dhe vlerat e Parkut Kombëtar “Mali Sharr”. Në fakt kjo pjesëmarrje është realizuar me iniciativën e z. Yves Fouque, konsultat i CRET-it, i cili në një farë mënyre ka qenë koordinator i gjithë këtij aktiviteti. Për Kosovën në përgjithësi, kjo ishte hera e parë që po prezantohej para një auditoriumi dhe pjesëmarrjeje të një niveli gjithë botëror.

Në mesin e pjesëmarrësve ishin disa nga shtetet më të fuqishme dhe kompanitë me renome botërore, të dëshmuara në aspektin e vlerave dhe destinacioneve të turizmit natyror. Prezantimi i tyre ishte dinjitoz dhe rezultat i një përvoje shumë vjeçare në këtë fushë të rëndësishme të zhvillimit në përgjithësi. Ndër to më të dalluarat ishin Zvicra, Italia, Franca, Turqia, Sllovenia, Irlanda, Amerika, Norvegjia, Maroko etj. me të cilat kemi arritur të vejmë kontaktet e para të bashkëpunimit.

Vizitorët: Ajo që të bije më së shumti në sy ishin vizitorët, pjesa më e madhe e të cilëve ishin të moshës së shtyrë, pensionistë dhe dashamirës të natyrës. Një pjesë e konsiderueshme e tyre mësonin për herë të parë për shtetin e Kosovës dhe mundësitë turistike që ofron vendi ynë. Në mesin e vizitorëve ishin edhe përfaqësues të pjesëmarrësve, me të cilët vazhdimisht janë realizuar kontakte dhe shkëmbyer informata, në bazë të të cilave jemi dakorduar edhe për agjenda të përbashkëta të bashkëpunimit të mëtejshëm (psh. Bullgaria dhe Holanda).

Ngjarje e veçantë ishte vizita e ambasadorit maqedonas dhe përkushtimin e tij për bashkëpunim lidhur me realizimin e projekteve të përbashkëta ndërkufitare në zonën e Maleve të Sharrit. Takim tjetër me rëndësi ishte vizita e organizatorit të panairit lidhur me mbarëvajtjen e panairit. Nga diskutimi konstruktiv dhe

shumë miqësor u veçua interesimi ynë dhe gatishmëria për bashkëpunim me të gjithë pjesëmarrësit e panairit. Në mes tjerash na u premtua se tash e tutje do të marrim ftesa të rregullta dhe përkrahje maksimale për prezantim sa më të pasur të destinacioneve turistike natyrore.

Prezantimi: hapësira dhe forma e prezantimit varej nga shteti ose organizata dhe mundësitë materiale që disponojnë. Kishte pjesëmarrës që zinin sipërfaqe të mëdha (Zvicra, Franca, Italia etj.) të cilat gjithashtu kishin edhe formën e prezantimit të veçantë. Oferta e tyre ishte maksimale dhe e shumëllojshme, afër të cilave nuk mund të kaloje indiferent. Në gjithë këtë labirint të hapësirave për prezantime edhe Kosova e kishte këndin e saj. E gjithë sipërfaqja e stendës ishte vetëm 9m2, dhe duhej të ndahej me përfaqësuesit e shtetit maqedonas. Në krahasim me të tjerët sipërfaqja ishte shumë e vogël, me një formë që nuk të ofronte mundësi të mjaftueshme për organizim. Edhe përkundër kësaj këndi ynë ishte njëra nga pikat më të vizituara (vërejte e organizatorit) ku janë ofruar informacione modeste dhe të mjaftueshme për destinacionin më atraktiv turistik në Kosovë - Parkun Kombëtar "Mali Sharr". Pjesë atraktive e këndit kanë qenë edhe disa produkte nga prodhues vendor (Vipa Chips, prodhuesi i verës "Stone Castle", prodhuesit e ëmbëlsirave "Liri") të cilët e ndihmuan pjesëmarrjen tonë në panair.



► Foto e mënyrës së prezantimit



Vështirësitë: Në përgjithësi pjesa më e vështirë ishte gjuha dhe komunikimi me qytetarët. Nuk jam i sigurt nëse kjo ishte fanatizmi i popullit francez që të komunikohet vetëm në gjuhën franceze, apo, mosnjohja e gjuhës angleze nga shumica me të cilit kishim kontakt – që të duket e pabesueshme. Kjo vështirësi vërehet menjëherë në aeroport, për tu bërë gati e pakuptueshme komunikimi me personelin e hotelit, me të cilët (duke e përfshirë edhe punëtorët e recepcionit) flisnim vetëm me duar. Në kuadër të panairit, këtë problem e kemi tejkaluar me ndihmën e përkthyesit të angazhuar nga z. Yves, me të cilin fatmirësisht mund të komunikojmë edhe në anglisht.

Vështirësi e veçantë në gjithë këtë ndërmarrje me rëndësi për Kosovën, ishte procedura fillestare e marrjes së vizave për udhëtim. Detajet e kësaj vështirësie besoj se janë të njohura për të gjithë, prandaj nuk ka nevojë të përmenden. Nuk ka rëndësi nëse je zyrtar më i lartë ose ke notë verbale të lëshuar nga Qeveria, është e kotë – duhesh patjetër ti nënshtrorsh procedurave që e "ndihmojnë" shumë lëvizjen e lirë të qytetarëve.

Lehtësirat: padyshim se njëra ndër pjesët më të mira të këtij aktiviteti ishte Ambasada e Kosovës dhe ndihma e saj logjistike. Gjatë gjithë kohës, stafi i saj ishte bashkë me ne dhe në shërbimin tonë, duke na bërë më të lehtë lëvizjen dhe njohjen me njërin nga qytetet më të mëdha botërore.

Koha e lirë: që kishim në dispozicion ishte shumë e shkurtër për të vizituar vetëm disa nga pjesët më të rëndësishme të qytetit. Këto lëvizje i realizuam me ndërrime, duke shfrytëzuar ndihmën e ambasadës së Kosovës dhe duke shfrytëzuar alternativat e shumta që ofroheshin përmes transportit publik.

PARISI

Parisi është një kombinim i të bukurës historike dhe zhvillimit shumë të hovshëm ekonomik, me fokus në fushën e kulturës duke përfaqësuar në të njëjtën kohë qendrën më të fuqishme të biznesit, të shkencës dhe administratës në Francë dhe në Evropë në përgjithësi. Qytet shumë i madh dhe shumë i shtrenjtë, me një transport shumë mirë të organizuar dhe i të gjitha alternativave të mundshme, nga të cilat më e preferuar është udhëtimi me metro, që i lidhë të gjitha pikat e rëndësishme të Parisit në mënyrë shumë efektive dhe të shpejtë. Sipas shumë njohësve dhe faqeve të rëndësishme në internet, Parisi është kryeqendra e botës, apo e ashtuquajtur qendra botërore e kulturës.

Në bazë të informatave të marra nga burime të ndryshme, në Paris janë të regjistruara 10 mijë pika turistike të cilat mund të vizitohen nga turistët. Prej 75 milion turistëve nga të gjitha anët e botës që për çdo vit e vizitojnë Francën, vetëm Prasin e vizitojnë 45 milion prej tyre. Turizmi dhe sektorët që ndërlidhen me të është njëra nga degët më të fuqishme të zhvillimit, nga i cili jetojnë një pjesë e konsiderueshme e popullatës. Prandaj, në çdo hap dhe nga çdokush vërehet qasja dhe përkushtimi për ruajtjen dhe trajtimin e duhur të trashëgimisë kulturore, si njëra nga mundësitë më fitimprurëse të ekonomisë në përgjithësi.

Me gjithë rrethinën, në Paris jetojnë më shumë se 12 milion banorë, ndërsa vetëm në zonën e ngushtë urbane më tepër se 2.5 milion banorë. Duke iu falënderuar dy miqve të mi, të cilët më shoqëruan për një pasdite të tërë, u njoftova se zona e ngushtë urbane është e ndarë në 20 komuna, nga të cilat më e njohura është e ashtuquajtura “e gjashtëmbëdhjeta”. Nëse je banor i kësaj komune të takon epiteti i një banori të pasur, sepse në të jetojnë popullsia më e pasur e Parisit. Me ndihmën e miqve u bë e mundur që të vizitojë disa nga pikat më të rëndësishme turistike të Parisit.




► Harta dhe pamja nga lartë e zonës urbane



Atraksionet kryesore të Parisit janë Disneyland-i i Parisit me më shumë se 15 mil. vizitorë në vit, pastaj Katedrala Notre Dame me më shumë se 13 mil., Muzeu i Luvrit me 9 mil. Kulla e Eiffel-it me 7 mil. vizitorë e kështu me radhë, që e bëjnë Parisin njërin nga qytetet më të vizituara botërore.

Kulla e Ejjellit - paraqet pikën qendrore e cila të bie në sy nga të gjitha anët e qytetit, prandaj vizita e saj për shumë kë është e pa evitueshme. E ndërtuar në vitin 1889 ka prezantuar objektin më të lartë të kohës në botë dhe arrijtet në mënyrën e ndërtimit. U ndërtua me rastin ekspozitës botërore dhe shënimit të 100 vjetorit të Revolucionit Francez. Pas njëzet viteve ka pasur zëra të shumtë që rekomandonin rrënimin e kullës, por ishte arsyeja e përdorimit për radio transmetues që e shpëtojë.



► Foto e kullës ditën dhe natën në momentin e ndezjes së dritave që ndodhë çdo orë

Katedrala Notre Dame – është njëra nga katedralet më të bukura në botë, ndërtimi i së cilës ka filluar në vitin 1163 dhe ka përfunduar në vitin 1250. Ndërtesa është një shembull i rëndësishëm i arkitekturës gotike në Francë e kombinuar me skulptura dhe gjam të dekoruar. Katedralja është monumenti më i popullarizuar në Paris dhe në përgjithësi në Francë, duke e mposhtur edhe Kullën e Eiffelit për nga numri i vizitorëve. Katedralja është gjithashtu kishë aktive katolike, vend i pelegrinazhit dhe pika kryesore katolicizmit në Francë në të cilën organizohen ngjarje të rëndësishme të religjionit. Njëra nga ngjarjet kryesore që u zhvilluan në këtë objekt ishte shpallja e Napoleon Bonapartës – imperator i Francës në vitin 1804. Dëmtimet më të mëdha janë shënuar gjatë Revolucionit Francez pas të cilit në disa perioda janë ndërmarrë aktivitete për restaurimin e sajë. Restaurimet kryesore janë realizuar nga viti 1991 që kanë zgjatur më shumë se dhjet vite, për të ardhur deri te pamja e mrekullueshme ditëve të sotme.

► Foto e katedrales Notre Dame



Muzeu i Louvrit – njëri ndër muzetë më të mëdhenj dhe më të vizituar në botë, që vizitohet nga të gjithë që kanë interes në art. Në fillim të ekzistimit ka shërbyer si pallat mbretëror për tu shndërruar në objekt publik në shekullin 18. Është pjesë e komunës së parë (nga 20 sa i ka i tërë Parisi) e vendosur në zemrën e Parisit. Aty janë të vendosura më tepër se 35.000 objekte, të shpërndara në tre krahët ish pallatit mbretëror që përfaqësojnë fakte nga antikiteti e deri në shekullin e XIX. Pa dyshim se njëra nga atraksionet kryesore të muzeut është Monalisa e famshme e Leonardo da Vincit.

Shtesa më e re që i është bërë muzeut, është piramida e xhamit e cila shërben si hyrja kryesore në muze. Për këtë ndërhyrje në fillim kishte reagime të ndryshme, ndër të cilat kryesore ishte kontrasti në mes të një objekti shumë modern dhe objekteve klasike përreth. Por sot kjo zgjidhje është pranuar nga të gjithë si zgjidhje e mençur dhe atraktive që ofron një hyrje shumë të madhe dhe të pasur, pa e dëmtuar trashëgiminë historike.



► Foto e piramidës hyrëse në muzeun e Louvrit

Champs-Elysees Avenue – është njëra nga rrugët, shëtitoret, aletë më të njohura në botë, në të cilën janë të vendosura dyqanet dhe zyrat e kompanive me renome botërore. Është rruga më e shtrenjtë në botë pas City's Fifth Avenue të New York-ut në të cilën qiraja për një hapësirë prej 100 m2 është deri në 50.000 € në muaj. Shëtitorja është e gjatë 2 km dhe është pjesë e komunës tetë në veri-perëndim të qytetit, që fillon nga sheshi Concorde në lindje, deri te Porta Triumfale në perëndim, e ndërtuar për të festuar triumfin e Napoleonit në Austri.

► Foto e rrugës më të njohur dhe më të bukur në botë Champs-Elysee



Në përfundim

Përshtypja e përgjithshme ishte se pjesëmarrja u tregua shumë e rëndësishme dhe në të njëjtën kohë e domosdoshme. Këso ngjarjesh janë njëra nga mundësitë më të mira dhe më të fuqishme për promovimin e Kosovës në përgjithësi dhe në veçanti të vlerave dhe destinaconeve turistike natyrore.

Duke e analizuar pjesëmarrjen dhe në bazë të diskutimeve, të gjithë u pajtuam se: duke mos përjashtuar pengesat e përmendura (hapësirën dhe përvojën minimale) kemi mundur të prezantohemi më mirë. Natyrisht se kjo duhet të na shërbejë si përvojë dhe motiv që për rastet tjera të organizohemi më mirë, të marrim informata detaje për hapësirën e prezantimit, të përgatisim materiale të bollshme dhe më efektive dhe padyshim na nevojitet një bashkëpunim më i ngushtë me sektorin privat, në mënyrë që bashkërisht të prezantohemi në mënyrën më të mirë të mundshme.

Edhe në këtë vizitë ngjashëm me vizitën e realizuar në Stamboll, u vërtetua se turizmi është njëra ndër degët më profitabile për një vend. Stambolli, por edhe Parisi në këtë rast, janë shembujt më të mirë që e dëshmojnë një konstatim të tillë. Ajo që është e rëndësishme - trendi i zhvillimit të kësaj dege është në rritje të vazhdueshme falë qasjes dhe përkushtimit ndaj trashëgimisë kulturore në të gjitha format e saja.

Luan Nushi, drejtor
Instituti për Planifikim Hapësinor
Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Prishtinë, 20.04.2012